



OLIMPIADA KOMBËTARE E GJEOGRAFISË
NË ARSIMIN E MESËM TË LARTË

Faza e dytë

Klasa 11

08 shkurt 2025

Udhëzime për nxënësin:

- Olimpiada fillon në orën 10.00 dhe mbaron në orën 13.00.
- Testi përmban 5 pyetje.
- Për secilën pyetje është lënë hapësira e nevojshme për të shkruar përgjigjen.

Për përdorim nga komisioni i vlerësimit

Pyetja	1	2	3	4	5
	10 pikë	10 pikë	10 pikë	10 pikë	10 pikë
Pikët e fituara					

Totali i pikëve

KOMISIONI I VLERËSIMIT

1.....Anëtar

2.....Anëtar

1. Klima e vendit tonë është nën ndikimin e faktorëve të ndryshëm. Njëri nga këta faktorë është qarkullimi i masave ajrore.

a) Evidentoni tiparet e tre tipave të qarkullimit të masave ajrore në vendin tonë.

3 pikë

Tipi i qarkullimit të masave ajrore perëndimore. Këto masa lëvizin nga perëndimi drejt lindjes me mbizotërim në dimër dhe në verë.

Tipi i qarkullimit të masave ajrore lindore. Këto masa ajrore lëvizin nga lindja dhe verilindja në perëndim, me rastisje të vogël gjatë dimrit, vjeshtës dhe pranverës dhe lidhen shpesh me shfaqjen dhe veprimin e anticikloneve të përkohshëm.

Tipi i qarkullimit të masave ajrore meridionale. Këto masa ajrore me drejtim nga veriu në jug dhe anasjelltas. Mbizotërojnë më shumë në stinën e pranverës të lidhura kryesisht me formimin e qendrave me trysni të lartë në veri të vendit tonë dhe me trysni të ulët në Mesdhe.

b) Era është një nga elementet klimatike me tipare dalluese edhe për klimën e vendit tonë. Shpjegoni karakterin stinor të drejtimit të erërave në Shqipëri dhe ndikimin e tyre.

4 pikë

Në gjysmën e ftohtë të vitit, sidomos në dimër, ajri i ftohtë mbi gadishullin e Ballkanit synon të zhvendoset drejt deteve më të afërta (Adriatik dhe Jon). Si rezultat në dimër mbizotërojnë erërat juglindore, lindore dhe veriore që vijnë nga brendësia e Ballkanit drejt deteve rrethuese më të ngrohta. Këto erëra ndikojnë më shumë në zonat lindore, janë të ftohta dhe sjellin temperatura të ulëta.

Gjatë gjysmës së ngrohtë të vitit sidomos në verë ndodh e kundërta. Rastisjen më të madhe e kanë erërat perëndimore, jugperëndimore dhe veriperëndimore. Në pranverë shtohen rastisjet e erërave perëndimore ndërsa në vjeshtë ato lindore.

c) Në cilat rajone gjeografike të vendit tonë shfaqet më shumë karakteri stinor i erërave? Argumentoni përgjigjen.

3 pikë

Karakterit stinor i erërave është më i theksuar në Rajonin Perëndimor të vendit tonë dhe në pjesën perëndimore të Rajonit Jugor. Ky karakter i theksuar lidhet ngushtë me ndryshimin e madh midis ngrohjes dhe ftohjes së tokës dhe ujit (deteve) dhe me ndikimin shumë të madh të faktorit reliev në rajonet e brendshme të vendit tonë.

2. Natyra e relievit shqiptar konsiderohet unike dhe e veçantë.

a) Evidentoni veçoritë hipsometrike të relievit shqiptar.

2 pikë

Karakteri i theksuar kodrinor-malor; lartësia mesatare 708 m; lartësia më e madhe është 2751 m në malin e Korabit por nuk mungojnë dhe pika me -8 m në ish kënetën e Tërbufit pra dallohet për amplitudë të lartë hipsometrike. Relievi ka copëtim të madh vertikal dhe pjerrësi të madhe të shpateve. Dukuri dalluese hipsometrike është dhe ulja karakteristike e relievit nga lindja në drejtim të perëndimit e cila bëhet më e qartë në pjesën qendrore të vendit.

b) Analizoni proceset modeluese të relievit shqiptar për:

5 pikë

Rajonet malore: proceset kryesore modeluese janë ato të erozionit lumor e të përrenjve për shkak të pjerrësisë së relievit dhe reshjeve të bollshme. Nuk mungojnë në modelim dhe rrëshqitjet.

Rajonet e gropave: në gropat ku ka ngritje aktuale mbizotërojnë proceset gërryese të ujërave rrjedhëse, ndërsa në gropat në ulje aktuale vihet re mbizotërimi i proceseve akumuluese (grumbulluese).

Rajonet e kodrave: në këto rajone për shkak dhe të mbizotërimit të shkëmbinjve terrigjenë mbizotërojnë proceset gërryese, rrëshqitjet dhe shpëlarjet sipërfaqësore.

Rajonet fushore në pjesën perëndimore: në rajonet fushore të pjesës perëndimore mbizotërojnë proceset grumbulluese të pjesës më të madhe të lumenjve që e përshkojnë atë.

Rajonet bregdetare: në brigjet e ulëta mbizotërojnë proceset akumuluese dhe në ato të lartat proceset gërryese (abrazioni).

c) Evidentoni karakteristikat dalluese të drejtimin të luginave lumore në relievin shqiptar.

3 pikë

Në pjesën e sipërme të tyre luginat lumore kanë drejtim kryesisht JL-VP. Në sektorët e mesëm dhe të poshtëm marrin drejtimin drejt perëndimit. Nuk mungojnë lugina me drejtim rrezor, me drejtim veri-jug dhe me drejtim jugperëndim-verilindje.

3. Analizoni në plan krahasues Rajonin Jugor me Rajonin Juglindor të Shqipërisë në këto aspekte: **10 pikë**

Ndërtimi gjeologjik

Rajoni Jugor përbëhet nga shkëmbinj gëlqerorë dhe terrigjenë, ndërsa Rajoni Juglindor përfaqësohet nga terrigjenë të llojit molasë dhe flish, gëlqerorë dhe magmatikë me përhapje më të kufizuar.

Strukturat në të cilat formohet relievi

Shkëmbinjte e Rajonit Jugor formojnë struktura gjatësore antiklinale. Strukturat shkëputëse gjenden në grabenin e Delvinës dhe Dukatiit. Ndërsa në Rajonin Juglindor strukturat e ndryshme rrudhosëse të përfshira fuqimisht nga lëvizje diferencuese me regjim mbizotërues në tërheqje u dhanë formë horsteve dhe grabeneve të mëdha. Ndër to grabenet e Korçës, Përrenjasit, Ohrit etj. Në Rajonin Juglindor strukturat rrudhosëse të përfshira nga lëvizjet ngritëse u copëtuan nga erozioni dhe një pjesë kanë formuar malësi.

Hidrografia

Hidrografia e Rajonit Jugor është shumë e pasur dhe përbëhet nga lumenj, ndër më të mëdhenjtë në Shqipëri; nga liqene të kripur si ai i Butrintit; nga burime të shumta ujore, ndër to karstike, minerale dhe termominerale, shtuar këtu zbulimin e liqenit më të madhe termal, ndërsa Rajoni Juglindor ndryshe nga Rajoni Jugor është më e varfër në lumenj të mëdhenj. Ai ndryshe nga Rajoni Jugor është i pasur me liqene të mëdha dhe me origjinë mbizotëruese tektonike.

Klima

Klima e Rajonit Juglindor dallohet për ndikim kontinental, me dimër të ashpër dhe me ngrica, ndërsa klima e Rajonit Jugor është tipike mesdhetare me dimër të butë dhe të lagësht dhe verë të thatë dhe të nxehtë. Reshjet e dëborës për Rivierën shqiptare të Rajonit Jugor janë të rralla ndryshe nga Rajoni Juglindor që kanë rastisje më të madhe.

Demografia

Në aspektin demografik zbulimet arkeologjike në Xarë tregojnë se Rajoni Jugor ka popullimin më të hershëm se rajonet e tjera të vendit përfshirë këtu dhe Rajonin Juglindor. Në të dy rajonet shpërndarja gjeografike e popullsisë është e pabarabartë. Në Rajonin Juglindor mbizotëron më shumë popullsia fshatare ndërsa në atë Jugor popullsia qytetare. Gjithashtu Rajoni Jugor dallohet për lindje më të pakta dhe për një përqindje më të lartë të lartë të popullsisë mbi 65 vjeç.

4. Shkruani një ese analizuese në lidhje me temën: *"Shkaqet e të gjitha formave të migracionit dhe pasojat mjedisore, sociale dhe ekonomike të migracionit në Shqipëri"*. **10 pikë**

Eseja në gjeografi do të vlerësohet për këto aspekte:

Hyrja / prezantimi – 2 pikë

Tregohet se për çfarë bën fjalë eseja.

Jepet një sfond për temën, rëndësinë e saj.

Jepen idetë/çështjet/ temat kryesore që do të trajtohen dhe radha në të cilën do të diskutohen ato.

Zhvillimi i argumenteve/analizës – 6 pikë

Shpjegohet këndvështrimi i nxënësit për temën e esesë. Argumenti zhvillohet teksa prezantohen pikëpamjet e nxënësit.

Trajtimi i çështjeve zhvillohet në një mënyrë sistematike dhe logjike dhe mbështeten me prova.

Përfundimi / konkluzionet – 2 pikë

Përfundimi është pika e fortë e esesë, ku shprehet qartë çështja kryesore dhe këndvështrimi i nxënësit për temën.

5. Shkruani një ese argumentuese me temë: *"Rritja e moshës mesatare të popullsisë: një problem vetëm në Shqipëri apo global."* **10 pikë**

Eseja në gjeografi do të vlerësohet për këto aspekte:

Hyrja / prezantimi – 2 pikë

Tregohet se për çfarë bën fjalë eseja.

Jepet një sfond për temën, rëndësinë e saj.

Jepen idetë/çështjet/ temat kryesore që do të trajtohen dhe radha në të cilën do të diskutohen ato.

Zhvillimi i argumenteve/analizës – 6 pikë

Shpjegohet këndvështrimi i nxënësit për temën e esesë. Argumenti zhvillohet teksa prezantohen pikëpamjet e nxënësit.

Trajtimi i çështjeve zhvillohet në një mënyrë sistematike dhe logjike dhe mbështeten me prova.

Përfundimi / konkluzionet – 2 pikë

Përfundimi është pika e fortë e esesë, ku shprehet qartë çështja kryesore dhe këndvështrimi i nxënësit për temën.